



Për: Znj. Albulena Haxhiu, Ministre e Drejtësisë
Z. Agim Veliu, Ministër i Punëve të Brendshme
Z. Aleksandër Lumezi, Kryeprokuror i Shtetit
Z. Bahri Hyseni, Kryesues i Këshillit Prokurorial
Z. Burim Berisha, Kryetar Komune, Fushë Kosovë
Z. Shpend Ahmeti, Kryetar Komune, Prishtinë

Nga: Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve

Lënda: Kërkesë për veprim

Data: 24 Shkurt 2020

Të nderuar,

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve i cili përfaqëson 29 organizata jo qeveritare, përmes kësaj letre shpreh indinjatën e thellë lidhur me veprimet e prokurorisë dhe performancën e dobët të gjithë sistemit të mbrojtjes, në trajtimin e rasteve ku fëmijët janë viktimë të formave të ndryshme të abuzimit dhe dhunës seksuale.

Rasti i fundit i publikuar në media që dëshmon dhimbshëm dështimin e sistemit për të garantuar mbrojtje për fëmijët viktimë të abuzimit, ka të bëjë me një fëmijë të moshës 12 vjeçare, i cili është abuzuar seksualisht dhe keqpërdorur në mënyrë sistematike. I dyshuari kryesor për abuzimin e fëmijës është i njohur për prokurorinë. Fëmija është vlerësuar pa përkujdesje prindërore prandaj është marrë në përkujdesje të institucioneve publike.

Është tejet shqetësues fakti që edhe gjatë kohës që fëmija pa përkujdesje prindërore ka qenë nën mbrojtjen e institucioneve publike, fëmija dyshohet të jetë abuzuar dhe keqtrajtuar përsëri nga i dyshuari.

Lidhur me këtë rast, kallëzimi i parë penal për trafikim është hedhur poshtë, kallëzimi i dytë për përdhunim dhe abuzim seksual është në procedurë të rregullt.

Megjithëse ekzistojnë dyshime të bazuara se ndaj fëmijës, në mënyrë sistematike janë kryer vepra penale kundër jetës dhe trupit - ngacmimi seksual, vepra penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriu - fotografimi dhe incizimet të tjera të paautorizuara si dhe vepra penale kundër integritetit seksual - dhunimi, sulmi seksual, degradimi i integritetit seksual dhe keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi, i dyshuari kryesor për të gjitha këto vepra është liruar nga prokuroria për mbrojtje në liri.

Një rast tjetër i ngjashëm dhe tashmë i njohur për opinionin ndodhi vitin e kaluar, kur prokuroria liroi në procedurë të rregullt të dyshuarin për përdhunim të fëmijës së mitur, rast i cili përfundoi me vrasjen makabre të fëmijës K.V. nga Fushë Kosova.

Jemi të shokuar për faktin që rasti tragjik i K.V. nga Fushë Kosova, nuk ka ndikuar aspak në reflektim, mobilizim e as ngritje të nivelit të përgjegjësisë së të gjithë sistemit të mbrojtjes së fëmijës, e sidomos të prokurorisë.



Të gjitha faktet e përmendura më sipër bëjnë që këto raste të jenë të patolerueshme dhe skandaloze. Nisur nga kjo, kërkojmë që qasja institucionale të jetë efektive e jo të rezultojë në vrasje dhe viktime tjera të abuzimit!

Ne, Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve kërkojmë nga shteti:

- Të kërkojë përgjegjësinë penale nga të gjithë palët e sistemit të mbrojtjes që dështuan të ushtrojnë obligimin ligjor të mbrojtjes së fëmijës (K.V) nga Fushë Kosova, duke shqiptuar dënimet e merituar.
 - o Kërkojmë rifillimin e hetimit të sistemit të menaxhimit të rastit të viktimës K.V., shqiptimin e dënimeve të merituar për personat përgjegjës për veprim apo mosveprim në ofrimin e mbrojtjes.
 - o Kërkojmë transparencë të plotë të procesit të sipërpërmendur.
- Të dërgohet urgjent në mbajtje i dyshuari për veprat penale i rastit aktual (fëmijës 12 vjeçar), si dhe të shqyrtohet e gjithë rrjedha e veprimeve procedurale të ndërmarra nga personat përgjegjës brenda institucioneve.
- Të kërkohet përgjegjësi penale nga prokurorët e të dy rasteve për veprimet e tyre.
- Të kërkohet ngritje e llogaridhënies së brendshme dhe të zbatohet detyrimi për respektimin e ligjeve brenda institucioneve përgjegjëse.
- Të garantohet mbrojtja adekuate e të gjithë fëmijëve si dhe viktimave të abuzimit dhe keqtrajtimit.

Mbesim në pritje të veprimeve urgjente të institucioneve të Republikës së Kosovës në lidhje me rastin.

Donjetë Kelmendi

Drejtor Ekzekutiv - KOMF

Sinqerisht,

Organizatave anëtare të KOMF: Asociacioni për Trajtime Sociale, Hulumtime dhe Avokim – ASTRA, Aksioni për Nëna dhe Fëmijë, Balkan Sunflowers Kosova, Childproof/CIPOF, Education Comes First – ECF, Iniciativa 6, Organizata Rinore Akti – Ora, Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP, OPFAKKOS, Programi për të Drejtat Civile – CRP/K, PL4Y International, Qendra për Arsim e Kosovës – KEC, Qendra e Kujdesit Ditor PEMA, Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të qenieve njerëzore – MVPT, Qendra për Studime të Avancuara – FIT, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT, Save the Children, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët Kosovë – SDSF, Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – PRAK Kosova, Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës – HANDIKOS, Terre des hommes, The Ideas Partnership, VoRAE, World Vision, Public Organization for Local Initiatives and Supports – POLIS, Network of Peace Movement – NOPM, Qendra Sociale – Edukative SOS Kopshti dhe Nevo Koncepti.